

PROVIMET ME ZGJEDHJE

LETËRSI

De Rada: Këngët e Milosaos – Kënga XXX

Fryu era e maleve
dhe rrëzoi hijen e lisit.
Gjaku im te lumi i Vodhit.
Hapeni shatoren,
O ushtarë, që të shoh
Shkodrën edhe time motër
te dritarja kundruall.
Atje nuk do zgjohem më
luleve që i tund era
si suvalë e pasosur
Mblidhen shokët mbrëmanet
në katund në vatërët.
Unë i lashë si ëndërrëz.

1. Milosao mishëron heroin:

- A) klasik.
- B) realist.
- C) romantik.
- D) sentimentalist.

2. Në vargun *dhe rrëzoi **hijen** e lisit*, poeti nënkupton:

- A) afrimin e vdekjes.
- B) lindjen dhe rilindjen e jetës.
- C) stoicizmin e heroit.
- D) shembjen e botës së vjetër.

3. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme shfaqet ideja se jeta vazhdon?

- A) Atje nuk do zgjohem më.
- B) Fryu era e maleve.
- C) Mblidhen shokët mbrëmanet.
- D) Unë i lashë si ëndërrëz.

4. Cila është figura stilistike e përdorur në vargun *dhe rrëzoi hijen e lisit?*
- A) Alegoria.
 - B) Metafora.
 - C) Metonimia.
 - D) Simboli.
5. Poezia “Fjalët e qiririt” e Naim Frashërit, është me motiv:
- A) atdhetar.
 - B) filozofik.
 - C) intim.
 - D) shoqëror.
6. Strofa e mëposhtme është shkruar me varg:
- Ndrrojnë prej dimnit landa veshen,
E lëshon gjethet që para pat;
E, për mëshirë, duhitë që ndeshen
Ia çojnë t’vorfnit me i ba shtat.*
- A) 6 - rrokësh.
 - B) 8 - rrokësh.
 - C) 10 - rrokësh.
 - D) 12 - rrokësh.
7. Në cilën nga poezitë e mëposhtme hasim pozicionin e poetit misionar?
- A) Fjalët e qiririt.
 - B) Nji vjet.
 - C) Poema e mjerimit.
 - D) Vdekja e nositit.
8. Në romanin “Doktor Gjilpëra” të Konicës, Dr. Gjilpëra përfaqëson njeriun:
- A) e etur për pushtet.
 - B) e kulturuar dhe të ditur.
 - C) e mbyllur në një jetë pasive.
 - D) me mentalitet të prapambetur.